



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER EDLIRA O. MALAJ
(GALANXHI)
ADRESA RR.SAMI FRASHERI,
PALLATI BLU PERBALLE
GJIMNAZIT PETRO NINI
LUARASI ,KATI 2
TEL: 694439947

KRIJIMI I SHOQATAVE OSE AKTI I THEMELIMIT (AKT THEMELIMI I QENDRES)

Nr. repertori: 2470

Nr. koleksioni: 1210

Tirane më 17/10/2024

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2024053010112842515

*Akti noterial përbëhet nga 2 fletë



A2024053010112691032

AKT THEMELIMI

Sot, para meje Notere EDLIRA O. MALAJ(GALANXHI), anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, RR.SAMI FRASHËRI, PALLATI BLU PERBALLE GJIMNAZIT PETRO NINI LUARASI ,KATI 2, u paraqit personalisht:

THEMELUESI:

Theodor Laci, atësia Pandeli , amësia Nazime, shtetas Britanik, lindur në Mitrovica dhe banues në Mitrovica, me adresë Mbreteri E Bashkuar, lindur më 27/08/1973, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. personal 128860879, .

I cili kane vendosur të themeloje shoqërinë tregtare “CVMR Albania” shpk, me kushtet si më poshtë:

NENI 1

STATUSI JURIDIK

Shoqëria Tregtare “CVMR Albania” Sh.p.k është formuar si Shoqëri tregtare sipas ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, (në vazhdim referuar si “Shoqëria”).

Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.

Ajo ka formën e një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar.

NENI 2

EMRI I SHOQËRISË

Shoqëria do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “CVMR Albania” Sh.p.k.

NENI 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:

- Nxjerrje, perpunim, pasurim, tregetim me shumice dhe pakice. import-eksport i te gjithë llojeve te mineraleve (si baker, krom, hekur, nikel, zink, qymyrguri, etj. xeherore dhe jo xeherore- dhe te nenprodukteve te tyre.
- Nxjerrje,perpunim, prerje , tregetim me shumice e pakice, import-export, e te githe llojeve te gureve (si (gur, mermer, granit, etj.) , deri ne pergatitien dhe ofrimin e produktit te gatshem.
- Ndertim rruges dhe konstruksion dhe hapje tunelesh, nen dhe mbi toke.
- Financim, pergatitje, zbatim dhe konsulence ne fushen inxhinierike, minerare dhe te ndertimit.
- Tregetim me shumice dhe pakice, per import dhe eksport i mallrave te ndryshem tekstile dhe industriale.
- Financime ne fusha te ndrshme.

NENI 4

SELIA E SHOQËRISË

Selia e Shoqërisë ndodhet në qytetin e Tiranës në adresën: “Bulevardi Deshmoret e Kombit 9, Tirane 10 10, Hotel Rogner”, Tiranë, Shqipëri.

NENI 5

KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali i shoqërisë është në vlerën 100 000 (njqind mije) leke, i ndarë në 1 (një) kuotë me vlerë nominale të një kuote prej 100 000 (njqind mije) lekë.

Z. Theodor Laci zotëron 1 (një) kuotë të kapitalit themeltar, pra 100 % të tij në vlerën 100 000 (njqind mije) lekë.

Kapitali themeltar është investuar nga ortaku themelues Z. Theodor Laci.

NENI 6

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Regjistrin e Biznesit. Ortakët e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e saj një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm.

NENI 7

ORGANET DREJTUESE

Bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve — organi më i lartë vendimarrës;



A2024053010112691032

2. Administratorët — organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë.

Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet nga Administratorët të cilët mund të zgjidhen për një afat deri në pesë vjet me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i Shoqërisë “___” Sh.p.k, është Z. Theodor Laci, i cili zgjidhet për një periudhë 5 vjecare me të drejtë ripërtëritje.

Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, apo çdo entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, i cili i ushtron të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 8

LIGJI I APLIKUESHËM

Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga Ortakët Themelues sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 9

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe që mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me Shoqërinë, do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 10

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Akt Themelimi përpilohet në 4 (kater) kopje në gjuhën shqip, dhe nënshkruhet nga ortakët i vetëm themelues. Unë Noterja verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 e vijues të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

THEMELUESI

Theodor Laci

Theodor Laci

NOTER

EDLIRA O. MALAJ(GALANXHI)